

KAPITULLI I

PAMJE E PERGJITHSHME MBI FINANCIMET E HUAJA NE MINISTRINE E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES GJATE VITIT 2007

Ekonomia shqiptare gjate vitit 2007 ka regjistruar rritje te qendrueshme dhe ne perputhje me parashikimet. Inflacioni eshte mbajtur nen kontroll dhe stabiliteti financiar eshte konsoliduar me tej. Rritja ekonomike reale gjate vitit 2007 vleresohet te ketë qenë rreth 6%. Kontribuesit kryesorë në rritjen ekonomike kanë qenë sektorët e transportit dhe telekomunikacionit, tregtisë, hotelerisë dhe restoranteve dhe në mënyrë të vecantë ai i industrisë. Norma mesatare e inflacionit vjetor për vitin 2007 ka rezultuar në 2.9%, kundrejt parashikimit prej 3% të Bankës së Shqipërisë. Luhatjet e inflacionit pergjate vitit 2007 kanë qenë kryesisht për shkaqe ekzogjene ndër te cilet peshen kryesore e kane pasur kriza energjitike, çmimet në rritje të naftës dhe drithërave, si dhe rritja ne pergjithesi e çmimeve të mallrave te importit.

Zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë gjate vitit 2007 kane dëshmuar nje rritje të mëtejshme të kërkesës së brendshme. Pavarësisht ecurisë pozitive të eksporteve, deficitit tregtar është rritur me 27% në terma vjetorë, duke arritur në 28% ndaj PBB-së. Kreditimi i ekonomisë në shkallë vendi ka qenë në një nivel të lartë prej 48,5%, pavarësisht se normat e rritjes së kredisë kanë shënuar një rënie në raport me vitin paraardhës. Kjo i dedikohet pranisë së kërkesës së lartë të sektorit privat për kredi, si dhe të gatishmërisë së lartë nga ana e bankave për të kënaqur këtë kërkesë. Gjate vitit 2007, raporti i kredisë për ekonominë ndaj PBB-së ka regjistruar zgjerim të ndjeshëm me 8.8%.

Gjate vitit 2007 Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës ka synuar me përparësi në përmbushjen e objektivave të përcaktuara në Programin e Qeverisë për një zhvillim ekonomik të shpejtë dhe të qëndrueshëm. Gjate ketij viti jane rishikuar teresisht politikat dhe strategjite per fushat ne varesi dhe eshte siguruar nje lidhje me e mire e programeve me prioritetet dhe politikat sektoriale, te cilat kane konsistuar ne: (i) sigurimin e nje furnizimi te pandërprere dhe me cilesi te konsumatoreve me energji nepermjet rritjes se investimeve ne sistemet e prodhimit, transmetimit dhe shperndarjes; (ii) nje shfrytezim racional te burimeve nentokesore te vendit (iii) thellimin e reformes rregullatore dhe permiresimin e kuadrit ligjor dhe institucional per zhvillimin e sektorit privat; (iv) mbeshtetje dhe zhvillim te SME-ve, rritjen e eksporteve dhe te financimeve te huaja direkte; (v) pergatitjen per privatizim te sektoreve strategjike; (vi) rritjen e shkalles se sigurise se mallrave dhe sherbimeve te ofruara ne treg; (vii) zgjerimin e bashkepunimit ekonomik dhe tregtar; (viii) pergatitjen e kuadrit te politikave dhe programeve qe do te mundesojne nje zhvillim te qendrueshem dhe te balancuar te rajoneve te vendit.

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes per realizimin e objektivave prioritare ne sektoret qe ajo mbulon, eshte mbeshtetur ne nje mase te konsiderueshme ne financimet e huaja, te cilat ne buxhetin e vitit 2007 zene peshen kryesore. Per vete peshen qe zene financimet e huaja ne buxhetin total te METE, nje nga synimet kryesore te METE gjate vitit 2007 ka qene edhe rritja e efienes se menaxhimit te asistences se huaj.

Per vitin 2007, METE ka parashikuar ne PBA 2007-2009 përfitimim e asistences se huaj ne vleren prej 1 545 150 mije leke, pa perfshire ketu financimet e huaja ne KESH si dhe financimet ne formen e grandeve te përfituar ne kuadër te programit CARDS. Duke mare ne konsiderate dhe financimet e angazhuara ne sektorin e energjise te cilat zbatohen nga KESH Sh.a, konkludojme se vlera e projekteve me financimim te huaj ne implementim

per vitin 2007 ne METE vlerësohet te jete 58.491.563 mije leke nga e cila 55.565.271 mije leke kredi dhe 2.926.292 mije leke grant. Aktualisht gjate vitit 2007 jane ne implementim 24 projekte me financim te huaj.

Ne PBA 2007-2009, METE eshte perfaqesuar me 6 programe kryesore:

1. Programi “ Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”;
2. Programi “Mbeshtetje per Energjine”;
3. Programi “Mbeshtetje per Burimet Natyrore”;
4. Programi “Mbeshtetje per Minierat dhe Ndermarrjet Publike ” ;
5. Programi “Mbeshtetje per Zhvillimin Ekonomik” dhe
6. Programi “ Sherbimet e Tregut, Akreditim dhe Inspektim”.

Asistenca e huaj per vitin 2007 ne nje mase te konsiderueshme ka qene angazhuar ne 4 programeve kryesore: “Mbeshtetje per Energjine”; “Mbeshtetje per Zhvillimin e Ekonomise”; “Sherbimet e Tregut, Akreditim dhe Inspektim” dhe “Mbështetje për Minierat dhe Ndërmarrjet Publike”.

Referuar numrit te projekteve per cdo program, shpërndarja e tyre sipas programeve rezulton si me poshte:

- Mbeshtetje per Energjine 13 projekte,
- Mbeshtetje per Zhvillimin Ekonomik 3 projekte,
- Sherbimet e Tregut, Akreditimi dhe Inspektimi 6 projekte,
- Mbështetje për Minierat dhe Ndërmarrjet Publike 2 projekt.

Vlera e financimit te huaj sipas programeve te METE

Nr.	Programet	Nr. Projekte	Vlera e projekteve(ne mije leke)			Disbursimi per 2007 (ne mije leke)
			Shuma Totale	Nga kjo:		
				Kredi	Grant	
1	Mbeshtetje per Energjine	13	52.340.797	51.233.797	1.107.000	5.416.183
2	Mbeshtetje per Zhvillimin Ekonomik.	3	4 809.574	4.331.474	478.100	79.600
3	Mbeshtetje per Minierat dhe Ndermarrjet Publike	2	787.692		787.692	
4	Sherbimet e Tregut, Akreditimi dhe Inspektimi	6	553.500		553.500	11.788
	Total	24	58.491.563	55.565.271	2.926.292	*

**Vlera e disbursimeve per vitin 2007 perfshin vleren e disbursimeve te projekteve qe menaxhohen nga KESH si dhe projekteve qe menaxhohen nga METE. Disbursimi i projekteve te financuar ne forme Granti, informacioni nuk disponohet*


Ne tabelen e mesiperme jepen te dhena te permbledhura mbi numrin e projekteve, vleren ne mije leke si dhe ndarjen sipas llojit te financimit ne Grant dhe Kredi. Referuar te dhenave per financimin e huaj te parashikuar ne PBA 2007-2009, per vitin 2007 jane parashikuar financim i huaj ne vleren prej 1 545 150 mije leke. Kryesisht ky financim eshte ne formen e kredise dhe konsiston ne mbështetjen e programit “ Mbështetje per Zhvillimin Ekonomik”.

Duke mare ne konsiderate edhe financimet e KESH Sh.a si dhe financimet ne grant te paparashikuar ne PBA, verehet se pesha me e madhe e financimit te huaj eshte përqendruar ne mbështetje te programit “Mbeshtetje per Energjine” ku shuma e projekteve te financuar per kete program arrin vleren 52 460 647 mije leke. Sqarojme se ne 12 projektet ne fushen e energjise, perfitues eshte KESH/ OST dhe se keto projekte nuk jane pjese e buxhetit te METE per vitin 2007. Gjithashtu, keto financime nuk perfshihen edhe ne tabelen e financimeve te huaja te Programit Buxhetor Afatmesem 2007–09.

Nisur nga pesha qe ze financimi i huaj per cdo program, vlerësohet qe financimi i huaj ne mbështetje te programit te energjise eshte afërsisht 90 % e financimit total per METE, per programin “Mbeshtetje per Zhvillimin e Ekonomise 8 % dhe afërsisht nga 1% per dy programet e tjera ; “Mbeshtetje per minierat dhe ndërmarrjet publike” ; dhe “Sherbimet e Tregut, Akreditim dhe Inspektim”.

Vlera e Financimi i huaj (ne përqindje) te angazhuar per cdo program.


(Graf 1)



❖ Financimi i Huaj sipas Formes se Financimit

Angazhimi i financimit te huaj eshte realizuar ne 2 forma kryesore nepermjet financimit ne kredi dhe grant. Referuar grafikut te meposhtem si dhe te dhenave ne table konkludojme se afersisht 95 % e projekteve me financimit te huaj per METE eshte financim ne forme kredie dhe 5 % financim ne grant. (graf 4)


(Graf 2)



Si eshte cilesuar edhe me siper, numri me i madh i projektve me financim te huaj eshte perqendruar ne programin “Mbeshtetje per Energjine”. Nisur nga rendesia e programit si dhe vlera relativisht e madhe e projekteve, mbeshtetja e ketij programi eshte realizuar kryesisht nepermjet financimeve ne forme kredie. Kjo justifikon dhe peshen e madhe qe zene financimet e huaja ne kredi ne krahasim me financimet ne grant ne nivel ministrie.

Nese financimi i huaj ne total do te zhvishej nga financimet per sistemin energjistik shqiptar ku perfitues eshte KESH/OST, raporti kredi/grant per 3 programet e tjera do te ndryshoje dhe konkretisht financimi ne kredi do te jete 70% ndersa financimi ne grant afersisht 30 %. (graf 5)

(Graf 3)




❖ **Donatoret Kryesore te Projekteve me Financimet e Huaj ne METE**

Nder donatoret me kryesore qe kane financuar METE mund te listojme: Banken Boterore; Banka Europiane e Investimeve (BEI); Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim (BERZH); Qeveria Gjermane (KfW); Qeveria Italiane; Qeveria Japoneze; Qeveria Spanjolle ; BE, etj.

Pjesa me e madhe e donatoreve eshte orientuar ne mbështetje te sektorit energjetik, ndersa per programet e tjera jane mbështetur kryesisht nga BE nepermjet Granteve te Programit “CARDS”.

(Graf 4)



Referuar totalit te financimeve te huaja te angazhuara ne sistemin e METE, do te vlerësonim si financues kryesore: BERZH dhe Qeveria Italiane (respektivisht me 21 %) ndjekur nga KfW (18%) ; Banka Boterore (15%) dhe BEI (12%). Lidhur me donatoret e tjere pesha e financimit te tyre qendron ne intervalin 1-3 % te financimit total.

❖ **Financimi i Huaj sipas Programeve Buxhetore**

▪ **Programi “Mbeshtetje per energjine”**

Sektori energjetik pas viteve 1990 është përballur me një kërkese ne rritje për elektricitet. Mbyllja e termocentraleve si dhe mungesa e investimeve ne kapacitetet prodhuese kane bere te pamundur plotësimin e nevojave ne rritje për energji. Gjatë vitit 2007 prodhimi në vend i energjisë elektrike në krahasim me vitin 2006 pothuajse u përgjysmua. Importet e energjisë ishin rreth 3 herë më të larta sesa një vit më parë. Për vitin 2007 oferta e agreguar e energjisë (importe dhe prodhim) ishte rreth 9% më e ulët sesa ajo e vitit 2006. Kërkesa për energji elektrike nga ana e bizneseve ka ardhur vazhdimisht në rritje, ndërkohë që konsumi i energjisë nga ana e tyre u rrit me rreth 20% gjatë këtij viti. Konsumi familjar vazhdon të marrë pjesën më të madhe të energjisë elektrike të furnizuar (rreth 60% të burimeve).

Gjate vitit 2007 është mundësuar përmirësimi i strategjisë per sektorin energjetik në të cilin parashikohet një kuadër politikash afatgjata që synojnë realizimin e objektivit për sigurimin e pandërprere te furnizimit me energji elektrike qe parashikohet të arrihet përmes përmirësimit të sistemit të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë. Sigurimi i burime financiare te huaja si dhe përdorimi me eficence i tyre përben alternativën bazë për kompensimin e nevojave financiare të sistemit energjetik si dhe zhvillimin e tij në një kohe sa më të shpejtë.

Si rezultat i nje pune intensive te bere gjatë vitit 2007 si dhe i permiresimit te ritmeve te disbursimit te financimeve te huaja, raporti i humbjeve teknike dhe joteknike ndaj sasisë së përgjithshme të energjisë së furnizuar, eshte permiresuar ndjeshem. Per vitin 2007 rënia më e madhe është regjistruar në kategorinë e humbjeve teknike.


Sistemi energjetik ne pergjithesi eshte mbështetur kryesisht nga kredite e huaja te ofruara ne terma te buta ose tregtare. Keto kredi menaxhohen nga KESH, nderkohe qe shlyerja e kredive ne pergjithesi garantohet nga Qeveria Shqiptare.

Donatoret kryesor ne energjetike bazuar ne shumen e kredise se financuar apo numrit te projekteve te financuar jane: Banka Boterore, Banka Europiane e Investimeve (BEI), BERZH, Qeveria Gjermane (KfW), Qeveria Italiane, Qeveria Japoneze, Qeveria Spanjolle etj.

Marrja ne analize e financimeve te huaja te angazhuara ne KESH Sh.a., behet per faktin se Minsitria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes eshte insitucioni pergjegjes per sektorin energjitik, si dhe per faktin se METE eshte insitucioni pergjegjes per mobilizimin e financimit te huaj ne kete sektor dhe hartimin e miratimin e marreveshjeve qeveritare te projekteve me financim te huaj per kete sektor, perfshire monitorimin e ecurise se ketyre financimeve.

Financimet e huaja per programin “Mbeshtetje per Energjine” sipas donatoreve.

(Graf 5)




Vlera e totale e financuar per 13 projektet eshte vlerësuar ne shumën totale prej 52.340.797 mijë leke. Nga kjo 51.233.797 mijë leke kredi dhe 1.107.000 mijë leke grant. Për vitin 2007 realizimi i disbursimeve për këto projekte kap shumën prej 5.416.163 mijë leke. Përqëndrimi i financimit të huaj në sektorin e energjisë është parë si domosdoshmëri në radhë të parë si rezultat i gjendjes së rënduar që ky sektor ka trashëguar si dhe sfidat me të cilat po përballë aktualisht, dhe në radhë të dytë për vetë rëndësinë e sektorit energjetik si një sektor kryesor për sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm të ekonomisë.

Realizimi i disbursimeve sipas projekteve per vitin 2007

NR	PERSHKRIMI I PROJEKTIT	Plani Disbursimeve 000/leke	Realizimi Disbursimeve 000/leke
1	Rehabilitimit dhe Ristrukturimit të En.EI	449657	449657
2	Gjenerimi dhe Ristrukturimit të En.EI. Pjesa 2	756762	490616
3	Projekti Vlorë	271430	271430
4	Projekti Fier	348900	0
5	Ndërtimi i T.E.C 100 MW Vlorë	3482894	1216381
6	Vau Dejes Region Transmission Distribution project	817259	643585
7	Kontroll monitorimi I tre nst 220 kV, OST, Tirana1, Elbasan1.	332300	0
8	Rehabilitimi I Kaskades së Drinit	323633	315774
9	Manaxhimi dhe rikonstruksionit teknik të KESH		52156
10	BISABU	1801044	804010
11	Linja 400 kV e Transmetimit dhe N/S Elbasan-Podgorice	3069750	1119013
12	Projekti i ri i TSO ECSEE APL-3	784476	53561
13	Promovimi I energjive të rinovueshme dhe efikasitetes së energjisë	0	0

(Graf 6)



Gjate implementimit te projekteve ne sektorin energjetik jane evidentuar veshtiresi dhe probleme te cilat kane shkaktuar vonesa ne disbursimin e financimeve te huaja dhe ne afatin e perfundimit te projekteve. Nje informacion me i detajuar per cdo projekt paraqitet ne seksionin V te ketij materiali. Ne menyre te permbledhur faktoret qe kane ndikuar ne vonesat e permendura me siper konsistojne ne :

- Parashikimet optimiste lidhur me nivelin e disbursimeve per vitin 2007 si dhe procesin e implementimit te projekteve. (Ne disa projekte jane bere parashikime teper optimiste mbi vleren e disbursimeve si dhe afatin e fillimit dhe perfundimit te projekteve.).
- Vonesa burokratike qe kane te bejne me dhenien e lejeve te ndertimit dhe miratimin e shesheve te ndertimit nga njesite qendrore dhe vendore .
- Faktoret qe lidhen me menaxhimin e projektit: Ne disa projekte jane verezitur vonesa dhe mos realizime nga ana e kontraktoreve persa i perket kerkesave te supervizionit te kontratave, etj.

▪ Programi “ Mbeshtetje per Zhvillimin e Ekonomise”.

Aktualisht gjate vitit 2007 jane implementuar ose kane qene ne proces implementimi nje numër i konsiderueshem i projekteve me financim te huaj. Drejtimet kryesore te asistences se huaj ne fushen e zhvillimit ekonomik konsistojne ne financimin e projekteve per permiresimin e klimes se biznesit dhe forcimit Institucional. Gjithashtu nje nga drejtimet kryesore te asistences se huaj ka qene edhe mbeshtetja e SME-ve si dhe pershpjtimi procedurave te regjistrimit te biznesit etj.


Vlera e asistencës se huaj te perfituar ne kete fushe per 3 projektet me te rendesishme kap shumen ne total 4.809.574e mije leke nga e cila 4.331.474 mije leke Grant dhe 478.100 mije leke Kredi.

Vlera e financimit te huaj e planifikuar ne PBA per vitin 2007 kap shumen prej 1.545.000 mije leke. Pjesen me te madhe te financimit te huaj te programuar per kete program e ze projekti “Mbeshtetje per SME” financuar nga Qeveria Italiane (1.240.000 mije leke) dhe Projekti BERIS i financuar nga Banka Boterore (150.000 mije leke). Aktualisht

projekti “Mbeshtetje per SME-te” nuk ka filluar ne vitin 2007 por pritet te implementohet ne vitin 2008 prandaj dhe niveli i disbursimeve per kete projekt eshte 0. Realizimi i disbursimeve per projektin BERIS kap shumen prej 79.300 mije lekesh qe perben nje realizim afërsisht 52.6% te planit te disbursimeve per vitin 2007.

Financimi i huaj per programin “ Mbeshtetje per zhvillimin e Ekonomise”

(Graf 7)



Aktivitetet e kryesore ne ketë fushe janë te lidhura drejtpërdrejtë me një nga objektivat kryesore te qeverise me sigurimin e një zhvillimi te qëndrueshëm dhe afatgjate te ekonomisë se vendit. Aktualisht ne mbështetje te programit operojnë një numër donatoresh si Banka Botërore, Italia, BE, etj.

▪ Programi “Mbështetje për shërbimet e tregut, akreditim dhe inspektim”

Prioritete kryesore ne fushen e mbikëqyrjes se tregut jane konsideruar: (i) Fuqizimi i konsumatorit shqiptar (zgjedhje reale e bazuar mbi një informacion të saktë, vetëvendosje e fortë, besim që rrjedh nga mbrojtja efektive): (i) Mbrojtja e interesave ekonomike të konsumatorëve Shqiptarë në çështjet e çmimit, zgjedhjes, sigurise, llojshmërisë, disponibilitetit (i) Ofrimi për konsumatorët Shqiptarë i nje mbikqyrje bashkëkohore dhe transparencë të tregut. (i) Mbrojtja e konsumatorit Shqiptarë nga risqet dhe kërcënimet të cilat ata nuk mund t’i trajtojnë e zgjidhin në mënyrë individuale.

Vitet e fundit si dhe gjate 2007 një rendësi e veçante i është kushtuar mbeshtetjes me investime te ketij sektori, ku një rol te rëndësishëm kane luajtur dhe financimet e huaja. Financimet e huaja jane fokusuar kryesisht ne: Mbeshtetje per akreditimin, standartizimin dhe certifikimin ne Shqiperi”; Infrastrukturen e Cilesise; Meteorologjine dhe Mbikqyrjen e tregut.

Për vitin 2007 mbeshtetja e asistences se huaj ka konsistuar ne implementimin e 6 projekteve (ne vazhdim) qe ne total kapin vlerën prej 533.500 mije leke, nga kjo 24.600 mije leke janë financim ne kuadër te Mbështetjes për forcimin e kapaciteteve institucionale te strukturave te ndihmës shtetërore. Projektet e mësipërme janë përfutur kryesisht ne kuadër te programeve te “CARDS” te financuara nga BE.

▪ **Programi “ Mbeshtetje per Minierat dhe Ndërmarrjet Publike”**

Politika e këtij programi konsiston në monitorimin dhe mbylljen e objekteve minerare e gjeologjike, mbrojtjen dhe rehabilitimin e mjedisit në zonat minerare të shfrytëzuara dhe privatizimin e aseteve; rritjen e sigurisë në punë në minierat me aktivitet prodhues; konservimin dhe privatizimin e aseteve të industrisë prodhuese.

Nje tjetër objektiv për këtë program është përmirësimi i mjedisit në ambientet ekzistuese apo të mëparshme industriale si dhe reduktimi i impaktit negativ në shëndet në lidhje me disa pika të nxehta në zonat industriale, realizimi i se ciles do të përmirësoje cilësinë e mjedisit dhe të jetës në këto zona.

Financimi i huaj për këtë program ka konsistuar në kryesisht të programit CARDS 2004 dhe CARDS 2005 me objekt grumbullimin dhe eliminimin e mbetjeve të rrezikshme industriale në zonat ku ato janë të evidentuara.

KAPITULLI II

ECURIA E PROJEKTEVE ME FINANCIM TE HUAJ SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE.

❖ PROGRAMI “MBESHTETJE PER ENERGJINE”

1-Projekti i rehabilitimit dhe ristrukturimit te Energjise Elektrike.

Projekti synon ne uljen e humbjeve teknike dhe joteknike te sistemin energjetik ne Shqiperi. Gjithashtu nepermjet ketij projekti do te mundesohet zbatimi i kontratatave per permiresimin dhe rehabilitimin e sistemit te transmetim shperndarjes dhe nenstacioneve ne qytetet Tirane, Kavaje, Korce, Berat dhe Lushnje. Projekti do te mbeshetese stabilizimin e sektorit elektrik duke permiresuar sigurine e sistemit, reduktimin e humbjeve si dhe fuqizimin e reformes institucionale. Progresi ne keto fusha do te lejoje terheqjen e investitoreve strategjik ne procesin e privatizimit te sektorit elektrik, qe parashikohet te realizohet ne vitet qe vijne. Projektit financohet nga EBRD

Vlera e projektit	27.8 mln/Euro
Financim i huaj	24,03 mln/euro
Financim lokal	516,588 mln/leke.
Data e fillimit :	18.03.2003
Data e mbylljes:	31.07.2006
Plani i disbursimeve per vitin 2007:	756.7 mln/Leke
Disbursuar per vitin 2007:	490,6 mln/Leke
Disbursimit progresiv :	2.853 mln/leke
Statusi aktual i projektit :	Projekti pritet te perfundoje ne fillim te 2008

Komponentet e projektit :

- Zgjerimi i rrjetit 220/20kV i N/S Tirana 1
- Permiresimi i rrjetit 20 kV ne Kavaje dhe Korce
- Permiresimi i rrjetit te shperndarjes 20 kV ne Lushnje dhe Uznove
- Konsulence teknike per projektin dhe Front Fee

Ecuria dhe Problematika e projektit: Projekti ishte parashikuar te perfundonte ne vitin 2006. Projekti pritet te perfundoje ne fillim te viti 2008. Shtyrja e afatit eshte rezultat i problemeve te hasura gjate zbatimit te kontrates “Dijetak-rrjeti i shperndarjes” dhe komponentit te permiresimit te rrjetit te shperndarjes 20kV ne Lushnje Uznove. Ndersa persa i takon ecurise se kontratatave te tjera te projektit ato kane perfunduar brenda afateve.

- Kontrata Dijekat-Rrjeti i shperndarjes parashikon ndertimin e 60 kabinave nga te cilat kane perfunduar se ndertuari 55 kabina. Ndertimi i kabinave ka patur veshtiresi te medha qe kane konsistuar ne gjetjen e shesheve te ndertimit. Kjo ka qene nje nder arsytet e mos ndertimit te 5 prej kabinave te parashikuara. Meqenese, kane kaluar te gjitha afatet kohore te projektit me nje shtyerje afati prej 18 muajsh nuk ka me kohe per venien ne pune te ketyre 5 kabinave.

Gjithashtu si rezultat i vjedhjeve dhe demtimeve qe jane bere ne linje eshte shtyre koha e realizimit te projektit. Projekti pas shtyrjes se afatit parashikohet te perfundoje ne fund te Marsit 2008 .

- Persa i perket komponentit “Permiresimi i rrjetit te shperndarjes 20kV ne Lushnje Uzrove” kane perfunduar punimet ne qytetin e Beratit ndersa per qytetin e Lushnjes eshte aplikuar nje shtyrje kredie. Per kete pjese te kontrates jane hasur probleme ne percaktimin e 10 shesheve te ndertimit per kabinat parafabrikat.

2-Projekti i Transmetim Shperndarjes Vau-Dejes

Projekti synon ne ndertimin e nenstacionit te ri 220/110/35/20 kV ne Kopluk dhe nenstacionit 110/20 kV ne Bushat si dhe rrjetit te transmetimit 110kV Vau Dejes - Bushat, duke permiresuar ne kete menyre shperndarjen e fluksit te energjise ne rrjetin 110 kV te rajonit te Shkodres dhe Lezhes. Projekti financohet nga BEI (Banka Europiane e Investimeve).

Vlera totale e projektit	10.9 mln/Euro ose 1 365.9 mln/leke
Data e berjes efektive	12 Janar 2006
Data e perfundimit te projektit	Tetor 2007
Plani i disbursimit per vitin 2007	6.5 mln/Euro ose 817.2 mln /leke
Disbursuar per vitin 2007	643.5 mln/ leke
Disbursimi progresiv	841,9 mln/leke
Statusi aktual i projektit	Projekt ne vazhdim

Komponentet e projektit

- Ndertimi i nensntacionit te Koplikut 220/110/35/20 kV.
- Ndertimi i nenstacioneve te Ri te Bushatit 110/20 kV
- Zhvillimi i kabllit 110kV per lidhjen e N/St Shkodra 1 e Shkodra 2 se bashku me nje dalje te re 110 kV ne N/St Shkodra 1.
- Vendosja e nje transformatori te ri 120 MVA ne HEC Vau i Dejes
- Ndertimi i rrjetit te ri 20 kV i qytetit te Koplikut me rreth 20km kabell 20kV dhe 29 kabina te reja parafabrikat 20/0.4 kV me aksesoret e duhura ne tension te ulet

Ecuria dhe problematika e projektit:

Ne pergjithesi punimet per kontratat e projektit kane evoluar dhe jane ne fazen perfundimtare. Per kontraten “Ndertimi i rrjetit te ri 20 kV i qytetit te Koplikut me rreth 20km kabell 20kV dhe 29 kabina te reja parafabrikat 20/0.4 kV me aksesoret e duhura ne tension te ulet” punimet vazhdojne me ritme te larta dhe jane ne fazen e perfundimit. Deri ne fund te vitit 2007 ka mbaruar linja kabllore 110 kV Shkodra 1 – Shkodra 2 e cila aktualisht eshte ne funksionim. Ka perfunduar ndertimi i linjes Bushat – Shkodra 2, jane bere bazamentet dhe eshte ngritur nje pjese e shtyllave per dy linjat e tjera Vau Dejes – Bushat dhe Vau Dejes – Shkodra 1.

Nenstacioni i Bushatit eshte ne fazen e testimit dhe komisionimit te paisjeve dhe parashikohet te perfundoje ne 15 Janar 2008. Ne HEC Vau Dejes eshte vendosur transformatori i ri 120 MVA eshte montuar trakti 220 kV dhe po punohet per ndertimin e traktit te ri 110 kV qe parashikohet te perfundoje ne fund te muajit Shkurt 2008.

Ne nenstacionin e Koplikut kane perfunduar punimet e ndertim montimit dhe ne fillim te muajit shkurt 2008 do te filloje faza e testimit te paisjeve dhe kolaudimit e cila eshte parashikuar te perfundoje ne fund te muajit Mars 2008. Persa i perket rrjetit 20 kV te qytetit te Koplikut eshte furnizuar 80 % e kabllit 20 kV dhe nje pjese e kabinave 20/0.4. Punimet parashikohen te mbarojne ne qershor te vitit 2008. Per kete projekt eshte shtyre afati i perfundimit te projektit i cili eshte parashikuar te perfundoje ne vitin 2008.

3- Kontrolli dhe Monitorimi i tre n/st 220kV OST, Tirana 1,Elbasan 1.

Projekti synon ne vendosjen e kontrollit te monitorimit dhe mbrojtjes per N/St kryesore te Tirana 1, Elbasani 1. Ky projekt do te permiresoje sigurimin e furnizimit me energji elektrike sidomos per zonen veriperendimore te Shqiperise si dhe do te rrise shkallen e modernizimit te nenstacioneve te transmetimit per lidhjet me UCTE. Projekti financohet nga BEI (Banka Europiane e Investimeve).

Vlera totale e projektit	3.69 mln/euro ose 461.4 mln/leke
Data e fillimit	Janar 2006
Data e perfundimit	Korrik 2007
Plani I disbursimit per vitin 2007	332.3 mln/leke
Disbursimi per vitin 2007	0
Disbursimi progresiv	46.14 mln/leke
Statusi aktual i projektit	Projekt ne vazhdim

Ecuria dhe problematika e projektit

Per N/st Tirana 1 ka vazhduar delivrimi i paneleve ne Shqiperi (panelet e mbrojtjes se linjave 220 KV) si dhe pjesa e mbetur e marshalling kiosk. Jane instaluar ne dhomen e nevojave vetjake panelet e rrymes se vazhduar dhe asaj alternative si dhe jane instaluar radrizaret. Ka vazhduar puna me shtrimin e kabllave te kontrollit duke realizuar shtrimin e kabllave te kontrollit per pjesen 220 KV si dhe ate 110 KV.

Per N/st Elbasan 1 vazhdon prodhimi i paneleve ne Greqi. Ka perfunduar rehabilitimi i dhomes se kontrollit dhe dhomes se kabllave. Ka perfunduar struktura metalike ne dhomen e kabllave si dhe ka filluar demontimi i nje pjese te kabllave te kontrollit. Jane instaluar radrizaret ne dhomen e nevojave vetjake.

Gjate realizimit te projekteve pavaresisht punimeve te kryera niveli i disbursimeve per kete vit ka qene 0. Punimet kane avancuar dhe niveli i faturuar eshte 472.764,2 EUR. Disbursimet nuk jane realizuar per arsye te mos plotesimit te dokumentacionit perkates nga kontraktori, qe ka penguar kalimin e fondeve. Pritet qe realizimi i disbursimeve per vitin 2007 te realizohet ne fillim te vitit 2008 .

4-Projekti i furnizimit te Jugut te Shqiperise (BiSaBu)

Projekti synon: Ne rehabilitimin e sektorit te gjenerimit , transmetimit dhe shperndarjes se energjise elektrike ne rrethet e Shqiperise se Jugut. Ky projekt perfshin rehabilitimin e HEC-eve Bistrica 1 dhe Bistrica 2, ndertimin e linjes se transmetimit 110 kV Bistrice Sarande, nenstacionet e Sarandes , Gjirokastres , rrjetin e shperndarjes se Sarandes dhe Gjirokastres etj. Perfundimi i ketij projekti do te mundesoje zhvillimin e sektorit elektroenergjetik ne te gjithe sektoret e tij duke rritur nivelin e furnizimit dhe profilin e tensionit te energjise se furnizuar.Projekti financohet nga Qeveria Gjermane (KfW)

Vlera e projektit	
Financim i huaj	33.7 mln/Euro
Financim Lokal	447.4 mln/Leke
Data e fillimit	18.07.2002
Data e perfundimit	31.12.2008

Plani i disbursimit per vitin 2007	1 801mln/leke
Disbursimi per vitin 2007	804 mln/leke
Disbursimi progresiv	3 066,2 mln/leke
Statusi i projektit	Projekt ne vazhdim.

Komponentet e projektit

- BISABU LOT I
- BISABU LOT II
- BISABU II AMEND 3 dhe 4
- Konsulenca Teknike per projektin

Ecuria dhe problematika e projektit.

Projekti BiSaBu ka filluar dhe po zbatohet ne baze te marreveshjeve 1998-65841 dhe 2003-66617 midis Republikes se Shqiperise(KESH) dhe qeverise Gjermane (KfW), projekt i cili eshte parashikuar te zhvillohet ne dy faza.

Faza e pare e projektit me vlere te kontrates 19,908 milione EUR, ka perfunduar me perjashtim te disa problemeve qe kane mbetur ne listen e difekteve. Dorezimi i certifikatave ToC/PTO eshte ne masen 96% dhe financimi eshte bere ne masen 75%. Persa i perket problematikes ne fazen e pare mund te permendim:

- a) Shqyrtimi i pretendimeve (claims) te konsortciumit
- b) Aplikimi i penaliteteve nga ana e KESH
- c) Tubacioni i tunelit(Penstock Gallery)

Konsortciumi ka dorezuar te gjitha pretendimet e veta ne daten 07.07.2007 me nje vlere 2,188,383 EUR. Pretendimet e kontraktorit jane si me poshte:

- Jane kryer punime shtese qe nuk parashikoheshin ne kontrate gjate rehabilitimit te objektit shkarkues te liqenit (bottom Outlet) me nje vlere prej 1,032,700 EUR.
- Jane kryer punime shtese gjate rehabilitimit te Bistrices 1. Keto punime te cilat jane kerkuar pjeserisht nga ana e KESH/RMU (sic pretendohet nga Kontraktori) dhe zbatuar ne baze te ofertave te dorezuara ne KESH/RMU nga ana e tij, kapin nje vlere prej 478,908 EUR.
- Simens S.A pretendon per nje shtese me nje vlere 676,775 EUR.

Ne vijim te ketij procesi, KESH nepermjet perfaqesuesit/supervizorit (Fichtner) i ka dorezuar Kontraktorit me 13.08.2007 nje raport te detajuar mbi llogaritjen e penaliteteve te mundshme qe kerkon te aplikoj si rrjedhim i zbatimit jo korrekt sipas kerkesave te Kontrates. Teorikisht kjo vlere penalitetesh shkon ne 1,990,882.33 EUR. Ne te njejten kohe Kontraktorit i eshte kerkuar te dorezoje materiale shtese e te detajuara me qellim analizimin korrekt te pretendimeve te tyre.

Ne tubacionin e tunelit eshte verejtur rrjedhje gjate pastrimit mekanik dhe mbrojtjes nga korrozioni. Punime paraprake jane kryer nga ana e RMU-se. Nje oferte per rehabilitim te plote te saj eshte dhene nga ana e Kontraktorit me nje vlere prej 3,730,190 EUR. Jane mare masat nga KESH dhe Fichtner per tu njohur me situaten aktuale te Tunelit. DVP-se i eshte dorezuar i gjithe dokumentacioni i nevojshem nga ana e DSP/PIU.

Gjithashtu problem ne kete faze eshte paraqitur edhe procesi i kompesimit te pronareve.

Pritet te dale VKM per kompensimin e pronareve te linjes 110kV Bistrice -Sarande.

Faza e dyte e Projektit eshte ne progres. Faza e dyte e projektit me vlefte 11,021 milione EUR, eshte ne progres zbatimi. Zbatimi i projektit per rehabilitimin e H/Centralit Bistrice 2 eshte me vonese. Keto vonesa kane ndodhur si rezultat mberritjes me vonese te pajisjeve te nevojshme ne fillim te projektit si dhe vonesa ne punimet per riparimet e nevojshme te percaktuara ne kontrate. Komisionimi i H/C Bistrice II eshte parashikuar te perfundoj ne Janar 2008 dhe venia ne operim eshte parashikuar ne Shkurt 2008. Aktualisht ka filluar komisionimi i Bistrices II dhe sipas skedulit te tij duhet te perfundoje ne 20 Mars 2008. Eshte kerkuar qe nga ana e kontraktorit te rritet performanca, numri i stafit si dhe pergjegjesit e penaliteteve qe rrjedhin nga vonesat. Kane perfunduar me sukses testimet e Turbines e cila eshte transportuar ne Hidrocentral dhe eshte ne procesin e montimit.

Persa i perket N/St te Sarandes shihet nje progres ne te gjithe punimet civile. Si rezultat i fillim me vonese te aktivitetit ne kete objekt vihet re nje vonese prej 4 muajsh per komisionimin e pergjithshem. Megjithate mendohet te mos kete impakt ne daten kontraktuale te perfundimit te projektit (18.06.2008). Data perfundimtare e perfundimit do te parashikohet pas perfundimit te riparimit te Transformatorit te Fuqise i cili aktualisht ndodhet ne fabriken prodhuese.

Progres ka pase edhe ne gjitha punimet civile te N/St Gjirokaster. Ka perfunduar me sukses testimi i Transformatorit te fuqise ne 17.07.2007. Megjithate nga raporti i progresit te Siemens A.E vihet re qe komisionimi i Transformatorit do te behet ne Prill/Maj 2008 dhe jo ne te njejten kohe qe mendohet te behet komisionimi i pjeseve te tjera te N/St.

Furnizimi i pajisjeve te TM nuk eshte respektuar nga ana e Siemen A.E. Ka patur vonesa ne shperndarjen e ketyre pajisjeve deri ne 4 muaj. Kontraktori pretendon qe vonesat jane shkaktuar si rrjedhim i rritjes se kohes se prodhimit te Transformatoreve ne tregun prodhues, dhe duke ju referuar dates perfundimtare te gjithe fazes se dyte te projektit, mendon qe nuk mund te zbatohen penalitete per kete pjese te projektit. Ne takimin e fundit te progresit eshte arritur ne perfundimin se ky problem do te zgjidhet pasi te perfundoj furnizimi i plote i pajisjeve.

6-Projekti i Elektrifikimit te Zonave Rurale

Projekti synon ne zhvillimin e rrjetit 220 kV nga Fieri ne Vlore duke krijuar premisa per zhvillimin e sistemit te transmetimit te zones se bregdetit dhe Jugut te Shqiperise. Financimi i qeverise Koreane ka te beje me projekte te transmetim shperndarjes ne zonat Fier-Vlore te cilat do te lehtesonin lidhjen e TEC-it te ri te Vlores me rrjetin e Transmetimit.

Vlera e projektit	
Financim i huaj	25 mln/USD ose 2 750 mln/leke
Financim Lokal	254 mln / leke
Data e fillimit	27.12.2004
Data e perfundimit	27.10.2007
Plani i disbursimit per vitin 2007	271.4 mln/leke
Disbursimit per vitin 2007	271.4 mln/leke

Disbursimi progresiv	2 592 mln/ lke
Statusi i projektit	Projekt ne vazhdim

Komponentet e projektit

- Projekti i elektrifikimit te zonave rurale
- Amendamenti Shperndarjes Vlore –Babice

Ecuria dhe problematika e projektit

Me 26 Nentor 2004 eshte nenshkruar kontrata per projektin me firmen fituese SUMSUNG CO dhe HYOSUNG CO. Kontrata eshte bere efektive ne 28 Dhjetor 2004. Me 27 Shkurt 2007 KESH ka leshuar Certifikaten e perfundimit te punimeve per N/St 220 kV Fier (Zgjerimi I daljes se linjes ajrore). Eshte nenshkruar nje amandament i ri per pjesen e mbetur te shumes se nenshkruar ne Marreveshjen e Kredise shuma e te cilit eshte 1.430.000 USD. Eshte kryer parapagimi ne nje mase prej 80% te shumes. Aktualisht Projekti i elektrifikimit te Zonave Rurale ka perfunduar fizikisht.

7-Projekti Fier

Projekti synon ne zevendesimin komplet te rrjetit te vjeter te tensionit te mesem 35/10/6 kV me rrjetin modern 110/20 kV per qytetin e Fierit. Gjithashtu ky projekt synon ne ndertimin e nenstacionit 100 MVA 110/20 kV te Fierit dhe furnizimin me te gjitha pajisjet dhe materialeve te nevojshme. Projekti financohet nga qeveria Spanjolle.

Vlera e projektit

Financim i huaj	9.3 mln/USD
Financim Lokal	457 mln/leke
Data e fillimit	Janar 2006
Data e Perfundimit	Korrik 2007
Plani i disbursimeve per vitin 2007	348.9 mln/leke
Disbursimi per vitin 2007	0
Disbursimi progresiv	0
Statusi i projektit	Nuk ka filluar.

Komponentet e projektit

- Ndertimi i N/stacionit 110/20 kV Fier (TEC)
- Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve per rrjetin e shperndarjes ne Fier.

Ecuria dhe problematika e projektit

Projekti ishte parashikuar te fillonte ne vitin 2006. Nisur nga ky fakt eshte parashikuar nje nivel i caktuar disbursimesh per vitin 2007 qe ishte konsideruar dhe viti i implementimit dhe perfundimit te projektit.

Ne negociimet me date 13-14 Nentor 2006 me kompanine kontraktore , Iberdrola kerkoi rritjen e vleres se kontrates 76% nga 9.3 milion USD ne 16.3 milion USD me pretekstin e rritjes se nivelit te cmimeve .Ky pretendim eshte refuzuar nga KESH, me argumentin se cmimet e materialeve ne teresi nuk kane patur nje nivel kaq te larte rritjeje, kurse indeksi i cmimeve te Spanjes per periudhen dy vjecare eshte rritur vetem 6.7%.

Aktualisht duke qene se cmimi i ofruar nga Iberdrola ishte shume i larte, i eshte kerkuar rishikimi i propozimit te bere. Pas negociatave te shumta eshte kerkuar nga Iberdrola nje reduktim te skopit te kontrates ne mase 44 %, si dhe nje rritje cmimesh ne te gjitha

elementet e kontrates.

Duke mare parasysh se kredia eshte kredi koncesionare me terma te buta si dhe duke konsideruar stadin e ketij projekti per te cilin eshte gjykuar se ne kete stad nuk ka tjetër mundesi financimi, eshte propozuar nga KESH pranimi i kushteve te vena nga Ibedrola (Kontraktor Spanjoll)

Pas negociatave te kryera gjate vitit 2007 me Ministrine e Financave dhe METE eshte rene dakort mbi pranimin e kushteve te Ibedroles. Per kete qellim eshte realizuar korrespondenca perkatese me Qeverine Spanjolle si dhe me Insitutin Spanjoll te Kreditimit dhe pritet konfirmimi i tyre.

Problemet e mesiperme kane bere qe projekti "Fieri" te mos implementohet ne vitin 2007 por pritet te filloje implementimi i tij ne vitin 2008.

8 - Projekti i manaxhimit dhe rikonstruksionit teknik te KESH

Projekti synon ne rritjen e performances tekniko-financiare te KESH-it dhe krijimin e kushteve per integrimin e sistemit tone elektrik ne rrjetet rajonale dhe evropiane. Me implementimin e ketij projekti parashikohen nderhyrje ne fuqizimin dhe rehabilitimin e sistemit te transmetimit e te shperndarjes, si ndertimi i nje nenstacioni te ri 220/110 kV ne Tirane, ndertimi i nenstacionit te ri Tirana Qender dhe Sauk si dhe fuqizimin e nenstacionit elektrik 110/20 kV te Pogradecit. Programi parashikonte gjithashtu furnizimin e materialeve e pajisjeve elektrike dhe mjeteve te transportit per nevoja te KESH-it si dhe ndertimi i zyrave per sektorin e shperndarjes. Projekti financohet nga Qeveria Italiane

Vlera e projektit

Financim i huaj	41.5 mln/euro
Financim lokal	832 mln/ leke
Data e fillimit	08.10.2004
Data e perfundimit	08.10.2007
Disbursimi per vitin 2007	400 mije/euro
Disbursimi progresiv	9 mln/euro
Statusi i projektit	Projekt ne vazhdim

Komponentet e projektit

- Studime fizibiliteti per Qendren Dispecer
- Ndertimi i Godines se KESH
- Ndertimi i linjes se re Tirana 1 Qender
- Ndertimi i linjes 110 kV Traktor-Selite-Sauk
- Ndertimi 220/110 kV Tirana 2 S/S
- Ndertimi i 110/20 kV Pogradec
- Ndertimi i 110/20kV Sauk
- Shperndarja Pogradec (10kV0

Ecuria dhe problematika e projektit

Marreveshja per "Programin e Ristrukturimit Teknik e Menaxhues te KESH-it dhe Fuqizimin e Sistemit Elektrik Shqiptar", me vlere 41.5 mln/Euro, e firmosur ne daten 13.02.2003, parashikon financimin e projekteve qe synojne rritjen e performances

tekniko-financiare te KESH-it dhe krijimin e kushteve per integrimin e sistemit tone elektrik ne rrjetet rajonale dhe evropiane.

Programi ka hyre ne fazen e implementimit qe nga viti 2003 dhe parashikohet te perfundoje ne vitin 2008. Deri tani eshte realizuar furnizimi i KESH-it me matesa elektrike, mjete teknologjike e te transportit si dhe kompjutera per sistemin e faturimit. Konkretisht kemi kete situatë zhvillimi per projektet e financuara nga ky program:

- Ndertimi i N/st. i ri 400/220/110 kV Tirana 2. (Gara eshte ne proces vleresimi);
- Fuqizimi i N/st. 110/20 kV dhe rrjetit elektrik te Pogradecit. (Ndodhet ne fazen perfundimtare te publikimit te gares);
- Ndertimi i N/st. elektrik 110/20 kV Tirana-Qender. (Ndodhet ne fazen e pergatitjes se dokumentave, me miratimin se fundi te sheshit te ndertimit nga Bashkia e Tiranes);
- Ndertimi i N/st. 110/20 kV Sauk. (Jemi ne fazen e pergatitjes se dokumentave, me miratimin e sheshit te ndertimit);
- Programi i Asistences per KESH/OST, eshte ne fazen e implementimit. Me kerkese te KESH-it dhe OST u rrit shkalla e fleksibilitetit te ketij programi.

Gjate implementimit te projekteve jane hasur veshtiresi ne sigurimin e shesheve te ndertimit te nenstacioneve dhe kryesisht jane hasur veshtiresi ne sigurimin e sheshit per ndertimin e Nenstacionit Sauk dhe ndertimin e Nenstacionit Tirana Qender. Aktualisht keto probleme jane zgjidhur dhe kontratat jane per proces zhvillimi.

9 - Projekti i fuqizimit te Operatorit te sistemit te Transmetimit

Financimi i qeverise Italiane per “ projektin e fuqizimit te operatorit te sistemit te Transmetimit” mbulon nje pjese te rendesishme te linjes 400 kV te interkoneksionit pjesen Elbasan-Tirane. Gjithashtu ky projekt konsiston ne ndertimin e nenstacionit 400 kV te Tiranes si dhe ndertimin e Qendres Dispeçer. Projekti manaxhohet nga PIU ne bashkepunim me PMU-OST dhe financohet nga Qeveria Italiane.

Vlera e projektit	51,5 Mln Euro
Data e nenshkrimit te mareveshjes	10.07.2006
Disbursimi per vitin 2007	0
Disbursimi progresiv	0
Statusi i projektit	Projekt ne vazhdim

Per te fuqizuar me tej infrastrukturen e sistemit tone elektrik ne daten 10.07.2006 u nenshkrua marreveshja per “*Ristrukturimin dhe Fuqizimin e Sistemit Elektrik Shqiptar per Integrimin ne Sistemin e Ballkanit*” me vlere 51.500.000,00 Euro. Me keto fonde parashikohet financimi i tre prej projekteve me te rendesishme te sistemit elektrik;

- Ndertimi i Qendres se re Dispeçer ne Tirane; (**Zbatohet nga PIU –OST**)
- Ndertimin e Linjes se interkonjeksionit 400 kV Tirane –Elbasan, pjese e projektit te Interkonjeksionit elektrik me Malin e Zi; (**Zbatohet nga PIU-OST**)
- Ndertimi i N/st. i ri 400/220/110 kV te Tirana 2. (**Zbatohet nga PMU Kooperacioni Italian, METE**)

Keto projekte kane hyre ne fazen e implementimit. Garat e zhvilluara per percaktimin e kontraktoreve jane hapur ne vitin 2007 dhe aktualisht jane ne fund te procesit te vleresimit te tyre. Pritet qe hartimi i kontratave per keto projekte te perfundoje brenda 3-

mujorit te pare 2008. Per keto projekte ende nuk kane filluar disbursimet pasi sic edhe permendet me siper garat jane ne proces vleresimi.

10-Projekti Linja 400 kV Elbasan-Podgoricë

Projekti synon ne rritjen e eficences dhe kapaciteteve te importit (nepermjet ndertimit te linjes se tensionit te te larte nderkufitare ndermjet Tiranes dhe Podgorices e cila i shton nje linjen 400 kV linjes ekzistuese 220 kv). Ndertimi i kesaj linje do te mundesoje plotesimin e nevojave te vendit me energji elektrike si dhe do te limitoje ne nje mase te konsiderueshme kufizimet e energjise elektrike per konsumatorët ne cfaredo kushti klimaterik. Investimi në sistemin energjistik shqiptar (ndërtimi i interkoneksioneve, TEC-i i ri dhe integrimi i sistemit energjistik me atë rajonal) ka jo vetëm qëllimin praktik të përmirësimit të furnizimit me energji elektrike, por edhe qëllim politik strategjik: forcimin e bashkëpunimit dhe ndërvarësisë rajonale. Projekti financohet nga Qeveria Gjermane (KFW) dhe është vazhdim i Projektit **te fuqizimit te Operatorit te sistemit te Transmetimit** te financuar nga Qeveria Italiane ne kuader te programit “Për ristrukturimin dhe fuqizimin e sistemit elektrik Shqiptar për integrimin e tij në sistemin e Ballkanit”

Vlera e Projektit	
Financimi i Huaj	43.8 mln/euro ose 5 469 mln/ leke
Financim Lokal	474 mln/leke
Data e fillimit	Mars 2005
Data e perfundimit	Qershor 208
Plani i disbursimeve per vitin 2007	1 640 mln/lek
Disbursimi per vitin 2007	1 119 mln/leke
Disbursimi progresiv	1 119 mln/leke
Statusi i projektit	Projekt ne vazhdim

Ecuria dhe problematika e projektit

Kontrata është bere efektive me dt. 08/11/2007 me pagesen e parapageses firmes kontraktuese. Kontrata ka nje kohezgjatje 24 mujore nga data e hyrjes ne fuqi te saj. Gjate 2007 nga ana e kontraktorit jane perfunduar, topografia dhe topologjia e trasese se linjes, jane porositur dhe perzgjedhur pajisjet kryesore te linjes (izolatore, percjelles, OPGW etj.) si dhe pajisjet primare te nenstacionit Elbasan 2, është percaktuar ne te shumten e saj traseja e linjes. Jane sjelle dhe perfunduar vizatimet dhe testimet per 4 tipe shtyllash. Ka perfunduar inspektimi dhe ka nisur prodhimi i shtyllave seksionit te pare te linjes (Kufi Mal i Zi/Shqiperi – Vau Dejes). Ka nisur puna ne terren lidhur me percaktimin e vendoshjes se shtyllave dhe nxjerrjes se listes se plote te pronareve per nisjen e procedurave te shpronesimeve.

Problemet e hasura deri me sot kane te bejne me teper me nevojën e devijimit te trasese ne afersi te zonave te banuara si dhe ne afersi te fabrikes se cimentos ne Fush – Kruje. Kontrata vlen te theksohet se po ecen sipas skedulit te percaktuar ne te.

11-Projekti per prodhimin dhe ristrukturimin e sektorit te energjise (Ndertimi i TEC-it, Vlore)

Projekti “ Ndertimi i TEC-it 100 MW Vlore” synon të arrijë përmirësime në rezultatet e sistemit energjetik (balancën në furnizimin dhe kërkesën për energji, efikasitetin në furnizim dhe përdorim, shëndoshjen financiare të sektorit financiar, dhe efektivitetin brenda sektorit), gjithashtu synon ne rritjen e prodhimit te energjise nga termocentralet në mënyrë që të plotësohen nevojat bazë të vendit (duke ulur ne kete menyre rreth 30% sasine e energjise se importuar).

Projekti eshte bashkefinansim i WB, BERZH, EIB si me poshte:

Banka Boterore	16 mln Euro (25 mln USD)
BERZH	40 mln Euro
BEI	40 mln Euro

Aktualisht realizimi i disbursimeve per vitin 2007 eshte 1222,7 mln/leke (perafersisht 14.5 mln USD) per projektin ne total, ndersa realizimi progresiv i disbursimeve nga fillimi i projektit deri ne Dhjetor 2007 kap shumen 1270 mln/leke (perafersisht 15 mln USD). Disbursimi i realizuar nga **financimi i Bankes Boterore deri ne Nentor 2007 arrin 900.000 USD (75 mln leke).**

Ndertimi i TEC eshte ne perputhje me strategjine e zhvillimit te sektorit elektroenergjetik. Termocentrali do te kete nje kapacitet te instaluar prej 97 MW dhe do te aplikojte teknologjine me ciklet te kombinuar, pra do te prodhoje energji direkt me turbinen e gazit te destinuar te punoje me lende djegese te gazte ose te lenget si dhe me turbinen e avullit te perftuar ne gjeneratorin e avullit nepermjet gazrave dales me temperature te larte te turbines se gazit. Ne kete menyre do te arrihen nivelet maksimale te rendimentit, i cili per te dy ciklet parashikohet te jete mbi 50%.

Ecuria dhe Problematika e projektit.

Tenderi eshte zhvilluar ne dy faza dhe ka perfunduar me 26 Janar 2006 kur bankat shpallen fituese te dy kontratave kompanine Italiane Maire Engineering. Vlera e kontrates per realizimin e projektit eshte 92 milione euro, per nje kapacitet te instaluar prej 97 MW.

Kontrata eshte nenshkruar me 9 Shkurt 2007 dhe ka hyre ne fuqi me 5 Maj 2007. TEC-i do te futet ne pune me kapacitet te plote me 5 Maj 2009, pas 24 muajsh nga berja efektive e kontrates.

Me 9 Shkurt 2007 eshte marre miratimi nga agjensia rajonale e mjedisit dhe me 03.03.2007 eshte marre leja e Mjedisit per ndertimin dhe Shfrytezimin e TEC-it.

Progresi i punimeve ne pergjithesi eshte i kenaqeshem. Tashme ka perfunduar i gjithe projekti i detajuar i vepres, porosite e pajisjeve dhe makinerive dhe prokurimi i tyre nga ana e kontraktorit. Ka perfunduar ngritja e kantjerit. Maire ka furnizuar te gjitha zyrat e pajisura si dhe deri me 10 shkurt perfundon linja definitive 20 kV e furnizimit me energji elektrike te TEC-it nga nenstacioni Vlora 1.

Eshte bere progresi ne prodhimin e pajisjeve kryesore turbina e gazit, turbina e avullit, gjeneratoret dhe kaldaja. Ka pak vonese ne punimet civile dhe ka nje mos ngutje nga ana

e kontratorit per punimet ne det. Edhe prokurimi i sistemeve mekanike eshte i vonuar por vonesa eshte e rekuperueshme.

Sipas mendimit edhe te Bankes dhe te konsulences, ka ardhur koha qe ndermarrja e Vlores te filloje te merret edhe me problemet e kontratave te shitjes se energjise elektrike, te blerjes se lendes djegese dhe te punesimit te operatorit te Vlores pune keto qe duhet te realizohen para komisionimit te TEC-it qe fillon nga fillimi i vitit 2009.

Nder problemet kryesore qe po manaxhojme aktualisht eshte problemi i pergatitjes per ndertimin e linjave 20 kV nst Vlora 1 dhe Linjes 220 kV TEC-Babice. Me i komplikuar eshte problemi me linjen 220 kV per arsye te kohes se limituar (6 jave). Per te paraprire ndertimit te linjes 220 kv jane mare masat e duhura ne bashkepunim edhe me Komunen Qender per kryerjen me urgjence te procedurave te marrjes me qera te tokes qe do te perdoret gjate ndertimit.

Ne fund te muajit dhjetor 2007 dhe fillim te mujit janar 2008 punimet ne TEC jane nderprere per arsye te protestave te "Aleances per Mbrojtjen e Gjirit te Vlores". **Per kete arsye nga kontraktori eshte kerkuar shtyerje te afatit te perfundimit te punimeve si dhe kosto shtese.** Aktualisht punimet vazhdojne normalisht.

12 - Projekti i energjise komunitare te Europes Juglindore (ECSSE-APL2) Shqiperi

Vlera e projektit eshte 48.9 mln USD ose 4 942 mln leke. Projekti eshte financim i perbashket i Bankes Boterore, BERZH-it dhe KESH Sh.a si me poshte:

Bankes Boterore	27 mln/USD
BERZH	20 mln/USD.
KESH	4.6 mln/USD.

Ky projekt synon:

- Rehabilitimin e N/st Tirana 1, Fier, Elbasan 1,
- Rehabilitimin e N/st Elbasan 2, Burrel Fierze, Koman, Vau i Dejes;
- Konsulence teknike per projektin, fuqizimin e OST dhe importin.

Kredia e Bankes boterore eshte bere efektive me 21 Dhjetor 2005. Projekti eshte parashikuar te implementohet per periudhen 2006-2009. Realizimi i disbursimeve per vitin 2007 per kredine WB kap shumen 59,84 mln/leke (perafersisht 712 000 USD) ndersa ai progresiv eshte 217,69 mln/leke (perafersisht 2.6 mln USD), kryesisht per konsulence teknike .

Ecuria e prokurimit te kontrates.

Hapja e tenderit u realizua me date 26 shkurt 2006. Gjate periudhes Mars 2006-Qershor 2007 jane hasur veshtiresi ne renien dakort mbi raportin e vleresimit te ofertave ndermjet konsulences dhe komisionit te vleresimit te ofertave. Ne gusht 2007 ne perputhje te plote me sugjerimet e bankes eshte bere raporti i ri i vleresimit per lotin e pare dhe te dyte. Propozimi per fitues per te dy lotet ishte per kompanine me cmimin me te ulet KONCAR. Raporti iu dergua edhe konsulences qe e mirepriti kete vendim. Nderkohe ka patur nje korrespondence te dendur ndermjet Komisionit te Vleresimit te Ofertave dhe Bankes Boterore ne lidhje me sqarime te ndryshme mbi dokumentacionin e ofertave. Ne dhjetor

2007 Banka i kerkon KESH te aplikojte shtese indeksi te kontrates per shtyrjet e afatit te vlefshmerise dhe pret raportin e ri te vleresimit, nese eshte e mundur te njejte me konsulencen, ne te kundert nje raport ku te shpjegohen pikat e mosrakovimit me raportin e konsulences. Ne 27 janar 2008 pas marrjes se miratimit edhe te konsulences TECSULT raporti i vleresimit i pergatitur nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave i eshte derguar Bankes Boterore per “no objection”. Pritet komenti i Bankes Boterore

Ne vijim te kesaj procedure, si rezultat i tejkalimit te afatit te vlefshmerise se ofertave eshte pare e domosdoshme qe t'u kerkohet ofertuesve shtyerja e vlefshmerise (validitetit) se ofertes. Afati i fundit i vlefshmerise se ofertave eshte data 24 shkurt 2008. Kesaj kerkese i jane pergjigjur pozitivisht vetem 4 kompani, dy prej tyre vetem per njerin lot.

13 - Programi “Promovimi i Energjive të Rinovueshme dhe Eficencës së Energjisë”,

Programi synon ne permiresimin e furnizimit me energji si dhe mbrojtjen e ambientit duke promovuar prodhimet kompatibel te energjise si dhe perdorimin me eficence te saj. Sot biznesi privat ne Shqiperi shfrytezon rreth 45 % HEC-e te vegjel dhe 3% HEC-e te mesem. Per rehabilitimin, venien ne shfrytezim dhe fuqizimin e tyre biznesi privat ka kryer investime me financimet nga burimet e tij. Projekti financohet nga KfW, në kuadrin e bashkëpunimit financiar të Gjermanisë me Shqipërinë.

Per sa me siper, programi financiar nga KfW eshte drejtuar ne ndihme te zhvillimit te sektorit te prodhimit te energjise elektrike, nga HEC-et e vegjel, duke krijuar nje fond, i cili do te lehtesoje financimin e ketyre projekteve, si dhe do te garantoje bankat vendase per te hyre ne fushen e financimeve te ketyre projekteve.

Projekti eshte grant ne vleren prej 9 milion Euro, nga te cilat:

- 7 milion euro programi i sektorit te energjise
(3.5 milion euro do ti jepen si garanci bankare per Hecet e vegjel
3.5 milion euro per eficencen e nergjise.)
- 2 milion euro do te jepen per konsulentet

Ky projekt konsiston ne:

1. Konsulence bankare
2. Konsulence per Hecet e vegjel
3. Konsulence per Eficencen e energjise
4. Konsulence per Tarifate
5. Konsulence per Fasilitetet e Energjive te Rinovueshme

Ecuria dhe problematika e projektit.

Agjencia ekzekutive e projektit eshte caktuar te jete Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore (AKBN) e cila eshte ne te njejten kohe dhe personi pergjegjes per palen shqiptare. Jane hasur veshtiresi qe lidhen kryesisht me mungesen e dokumentacionit zyrtar e cila nuk eshte deleguar nga Agjencia Kombetare e Energjisë (AKE) gjate procesit te ristrukturimeve institucionale ne kohen e krijimit te AKBN. Mungesa e dokumentacionit veshtiresoi njohjen me ecurine e deritanishme te projektit si dhe detyrimet qe lindin nga AKBN ne vijim te tij.

Gjendja e deritanishme ne lidhje me kete projekt dhe problemet kryesore per secilin Lot

jane:

1. Konsulenti MACS – Konsulenti i Bankave

Eshte bere perzgjedhja e Bankave nga konsulenti te cilat do te japin kredite sipas kriterëve te vleresimit te depozituar ne AKBN. Bankat e perzgjedhura per zhvillimin e procedurave per huadhenje afatgjate per 9 hece jane BKT dhe Raiffeisen Bank. Nga konsulenti eshte mare persiper dhe trajnimi i eksperteve prane bankave per dhenjen e asistences teknike per vleresimin e aplikimit per hua. Nga takimet e bera konstatohen qe problemet e dala jane te lidhura kryesisht me konsulentin Decon.

2. Konsulenti DECON- Konsulenti per Hecet e vegjel

Konsulenti ka perzgjedhur 9 Hece te vegjel (te privatizuara) per te cilat ka perfunduar studimi i prefizibilitetit. Per keto HEC-e kerkohet te kene rritje te kapacitetit te tyre gjeneruese, e cila do te behet ne baze te marreveshjes baze te blerjes se energjise. Gjithshtu per kete problem kerkohet te behen rregullime ne kuadrin ligjor persa i perket ligjit te koncesioneve. Per kete kerkohet qe te rritet afati i marreveshjes se blerjes se energjise me KESH (afati minimal eshte 3 vjet)

Nje tjetër problem per kete lot eshte “Step in Rights” (e drejta per tu bere pronar). Ky problem ende nuk eshte zgjidhur, pra nqs investitori deshton ne pagesen e borxhit te vet kundrejt bankes kjo e fundit mund te operoje ne HEC e vogla dhe mund ta shese/jape kete nje investitori tjetër qe mund ti paguaje huane. Gjithashtu kerkohet te rregullohet kuadri ligjor per “Take or Pay” (mere ose paguaj), kjo i jep Bankave Partnere (BP) siguri pasi nqs kompania e trasmetimit dhe shperndarjes nuk eshte ne gjendje ta marre te gjithë energjine e gjeneruar nga HEC ne baze te kontrates, atehere kompania duhet te kompesoje plotesisht HEC per energjine e gjeneruar. Vetem keshtu BP do te jene te binduara per te dhene hua pe zhvillimin e burimeve te rinovueshme.

3. Konsulenti LAHMAYER – Konsulenti per tarifate

Ne lidhje me LOT-in e Tarifave te kryer nga Kompania Lahmayer, eshte perfunduar ky LOT dhe eshte paraqitur Raporti perfundimtar.

Nga KBN ne rolin e PEA eshte organizuar

ka organizuar nje tryeze pune te perbashket midis perfaqesueseve zyrtar te Steering Committee METE, KESH, ERE per te dale me nje vendim te perbashket per kete raport te pales shqiptare. Pas ketij takimi ju dergua ketij Konsulenti dhe KfW aprovimi per raportin perfundimtar si dhe miratimi per aplikimin e tarifave te percaktuara ne kete raport.

4. Konsulenti EXERGIE- Konsulenti i Energjise se Rinovueshme

Konsulenti EXERGIE ka perzgjedhur 28 objekte publike si shkolla, kopshte, spitale ku mendohet te punohet per aplikimin e eficenses se energjise. Nga konsulenti eshte pergatitur gjithë dokumentacioni per te filluar procesin e tenderimit per objektin e pare, por nuk eshte zgjidhur ende problemi kryesor ai i pagimit te tvsh.

Bazuar ne art.4 te “Financing Agreement” te lidhur midis KfW dhe Ministrise se Financave eshte percaktuar qe Perfituesi (d.m.th pala shqiptare) do te perballoje te gjitha detyrimet dhe taksat. Duke gene se shuma e akorduar per kete lot eshte 3.5 milion euro

dhe pjesa e tvsh eshte e larte dhe duke qene se nuk eshte perfshire ne projekt buxhetin e vitit 2008 eshte propozuar qe kjo TVSH te paguhet nga METE pas perfundimit te punimeve per eficencen e energjise..

Probleme jane hasur edhe per procesin e zhvillimit te tenderimit per objektet nga AKBN duke ditur qe AKBN nuk ka nje njesi te specializuar si dhe specialiste te nevojshem per ti kryer zhvillimin e tenderimeve. Gjithashtu per te filluar punen ne te gjitha keto objekte duhet te merret dhe leja apo konfirmimi nga institucionet prej te cilave ato varen.

❖ **PROGRAMI “MBESHTETJE PER ZHVILLIMIN EKONOMIK”**

1-Projekti i Reformes se Mjedisit te Biznesit dhe forcimit Institucional (projekti BERIS)

Kredi e Bankes Boterore ne vleren 11 mln USD. Financim i IDA ne vleren 5 mln USD dhe IBRD ne vleren 6 mln USD.

Objektivi i pergjithshem eshte te ndihmoje qeverine per:

- a) lehtesimin e hyrjes se biznesit dhe te veprimtarive te tij ne vend dhe
- b) forcimin e aftesive te sektoreve te ndermarrjeve per te rritur eksportet drejt rajonit dhe tregjeve te BE-se.

Projekti perbehet nga tre komponente:

1. Lehtesimi i hyrjes dhe i veprimtarive te biznesit ne vend.
 - Permiresimi i rregulloreve qe ndikojne ne hyrjen dhe operacionet e biznesit ne vend;
 - Forcimi i kapacitetit institucional per zbatimin e regjimi politik te konkurrences se ndershme
2. Forcimi i aftesive te sektorit te ndermarrjeve per te eksportuar ne tregjet rajonale dhe te BE-se: Forcimi i sistemit MSTQ (Strategjia e Infrastruktures se cilesise).
3. Mbeshtetja per koordinimin e projektit

Ky projekt manaxhohet nga stafi i brendshem i Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes, pa PIU, ne perputhje me filozofine e re te Bankes Botere per manaxhimin e projekteve te financuara prej saj.

Ky projekt pati nje fillim te veshtire si rezultat i domosdoshmerise per t’iu pershtatur perqasjes se re te Bankes Boterore per zbatimin e projekteve. Gjithashtu, duhet nenvizuar se mungesa e ekspertizes se menjehershme dhe kapacitetet e kufizuara ne Ministrine e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes per ndjekjen e tij krijuan veshtiresi objektive per fillimin e zbatimit te projektit. Gjithesesi me angazhim dhe perkushtim eshte arritur qe tashme kjo veshtiresi te kapercehet dhe ndjekja e aktiviteteve ne kuader te ketij projekti te hyje ne nje proces te normalizuar.

Zbatimi me sukses i ketij projekti do te mundesoje realizimin e objektivave te CAS 2006-2009 per eliminimin e pengesave te panevojshme per zhvillimin e aktivitetit te biznesit si dhe permiresimin e kapaciteteve eksportuese nepermjet krijimit dhe konsolidimit te sistemit per manaxhimin e infrastruktures se cilesise (metrologji, akreditim dhe

standartizim)

Ne total jane disbursuar afersisht 910.000 USD.

2-Projekti “Mbeshtetje per SME”

Projekti synon ne zhvillimin e sektorit privat nepermjet nje kredie ne mbeshtetje te SME-ve si dhe ne asistencen teknike. Vlera e projektit eshte 29.4 mln/Euro nga kjo 27.5 mln/euro kredi e bute dhe 1.9 mln/Euro grand. Shuma prej 25 mln/euro do te perdoret per financimin e projekteve te SME-ve dhe shuma prej 2.5 mln euro do te perdoret per ngritjen e fondit te garantimit te kredive . Projekti financohet nga Qeveria Italiane.

Vlera e projektit	29.4 mln/euro
	27.5 mln/ euro kredi
	1.9 mln/euro grand
Afati i fillimit	2007
Afati i përfundimit	2007
Disbursimi	0

Projekti ishte parashikuar te fillonte ne vitin 2007 por për arsye te tërheqjes se agjensise se implementimit te projektit ky projekt parashikohet te filloje ne vitin 2008. Qeveria Italiane eshte duke pare mundesine qe Kooperacioni Italian ne Tirane te luaje rolin e Agjensise Implementuese te Projektit, pritet qe procedurat te perfundojne ne vitin 2008.

❖ PROGRAMI “MBËSHËTËTJE PËR MINIERAT DHE NDËRMARRJET PUBLIKE”

1-Projekti: “Ndertimi i vendgrumbullimit te mbetjeve te rrezikshme dhe rehabilitimi i ambientit perreth ne Uzinën Plehrave Azotike Fier”

Projekti synon ne identifikimin, pastrimin dhe rehabilitimin e ambientit ne te ashtquajturit Hot – Spote. Gjithashtu projekti synon ne eliminimi i mbetjeve te rrezikshme kimike dhe depozitimi ne vendgrumbullime specifike sipas natyres se mbetjeve. Projekti konsiston ne zgjidhen perfundimtare te problemit shumevjecar te eliminimit te lendes se rrezikshme solucion arsenikal i cili eshte kthyer ne gjendje te ngurte nepermjet projekteve te meparshem. Projekti realizohet ne kuadër te programit “CARDS 2005” dhe financohet nga BE nepermjet nje granti prej 1.54 milion Euro.

Gjate implementimit te projektit do te realizohen ; (i)punimet e demobilizimit dhe pergatitjes se terrenit per pune; (2) ndertimi i vendgrumbullimit sipas te metodave me moderne te perdorura ne Evrope;(3) depozitimi i arsenikut ne komponim te ngurte ne respektim te gjitha kushteve teknike dhe mjedisore;(4) kapsulimi i vendgrumbullimit te mbetjeve; (5) kthimi i terrenit ne nje zone te gjelbëruar.

Vlera e Projektit	1 540 mije Euro
Kontributi i Qeverise Shqiptare(TVSH)	310 mije Euro
Afati i implementimit	12 muaj
Statusi i projektit	Nuk ka filluar te implementohet.

Ecuria dhe problematika e projektit.

Ka përfunduar puna pergatitore per fillimin e projektit. Ne kete Kuader eshte kryer studimi i fizibilitetit mbi mundesine teknike te ndertimit te vendgrumbullimit nga kompani e huaj e kontraktuar nga Bashkimi Evropian ; ka përfunduar hartimi i raportit i vlerësimit te Ndikimit ne Mjedis ; eshte mare miratimi mjedisor nga autoritetet lokale dhe i Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier. Gjithashtu eshte siguruar leja mjedisore ne emer te METE.

Pervec miratimit mjedisor eshte plotesuar gjithë dokumentacioni tekniko-ligjor dhe eshte kryer aplikimi per lejet; shesh ndertimi dhe ndertimi.

Aktualisht implementimi i projekti nuk ka filluar. Kompania Fituese eshte ne pritje te marrjes se miratimit te sheshit te ndertimit dhe lejes se ndertimit te vendgrumbullimit te mbetjeve. Jane miratuara lejet e siperpermendura por akoma nuk jane zbardhur pasi pritet te behen pagesat e detyrimeve ligjore ne autoritetet lokale kompetente.

Sic theksohet me siper kohëzgjatja e projektit eshte 12 muaj. Data e fillimit te projektit nuk eshte e përcaktuar pasi kondicionohet nga marrja e lejeve te ndertimit te cituar me lart.

2. Projekti: “Ndertimi i vendgrumbullimit te mbetjeve te rrezikshme dhe rehabilitimi i ambientit perreth ne Uzinen e Metalurgjise Rubik”

Projekti synon ne identifikimin, pastrimin dhe rehabilitimin e ambientit ne te ashtquajturit Hot - Spote. Ne kete aspekt projekti synon ne eliminimin e mbetjeve te rrezikshme kimike dhe depozitimin tyre ne vendgrumbullime specifike sipas natyres se mbetjeve. Projekti konsiston ne zgjidhen perfundimtare te problemit shumevjecar te eliminimit te lendes se rrezikshme solucion arsenikal i cili eshte kthyer ne gjendje te ngurte nepermjet projekteve te meparshem. Projekti realizohet ne kuadër te programit “CARDS 2004” dhe financohet nga BE nepermjet nje granti prej 4.4 milion Euro.

Gjate implementimit te projektit do te realizohen ; (i)punimet e demobilizimit dhe pergatitjes se terrenit per pune; (2) ndertimi i vendgrumbullimit sipas metodave me moderne te perdorura ne Evrope;(3) depozitimi i arsenikut ne komponim te ngurte ne respektim te gjitha kushteve teknike dhe mjedisore;(4) kapsulimi i vendgrumbullimit te mbetjeve; (5) kthimi i terrenit ne nje zone te gjelbëruar.

Vlera e projektit	4 400 mije/Euro
Kontributi i qeverise Shqiptare	880 mije/Euro
Kohezgjatja	18 muaj
Statusi aktual	Nuk ka filluar te implementohet.

Ecuria dhe problematika e projektit

Ka përfunduar puna pergatitore per fillimin e implementimit te projektit. Ne kete kontekst eshte kryer studimi i fizibilitetit mbi mundesine teknike te ndertimit te vendgrumbullimit nga kompani e huaj e kontraktuar nga Bashkimi Evropian; eshte hartuar raporti i Ndikimit te Vleresimit ne Mjedis; Eshte marre miratimi mjedisor nga autoritetet lokale dhe Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhe. Eshte siguruar leja mjedisore ne emer te METE.

Eshte plotesuar gjithë dokumentacioni tekniko-ligjor dhe eshte kryer aplikimi per lejet shesh ndertimi dhe ndertim ne KRRT Lezhe. Jane miratuara lejet e siperpermendura nga KRRT Lezhe. Eshte plotesuar gjithë dokumentacioni tekniko-ligjor dhe eshte kryer aplikimi per lejet shesh ndertimi dhe ndertim ne KRRTRSH. Ne pritje per miratimin e ketyre lejeve nga KRRTRSH

Aktualisht implementimi i projektit nuk ka filluar. Kompania Fituese eshte ne pritje te miratimit te sheshit te ndertimit dhe paisjes me leje ndertimi nga KRRTRSH. Gjithashtu pritet te kryhet lirimi i ambientit nga sasia e hekurit dhe mineralit te bakrit te depozituar ne ambientin ku do te implementohet projekti, e cila do te realizohet nepermjet organizimit te ankandeve per shitjen e tyre nga ALBAKER sh.a.

❖ PROGRAMI “SHERBIMET E TREGUT, AKREDITIM DHE INSPEKTIM”

1-Projekti “CARDS 2006” Mbeshtetje per akreditimin, standartizimin dhe certifikimin ne Shqiperi”

Objektivi i ketij projekti eshte te lehtesoje tregtine dhe mundesine per investime ne Shqiperi nga rritja e cilesise dhe sigurise se produkteve shqiptare, pergatitja e DA per anetaresim te plote ne EA dhe njohja nderkombetare e raporteve te testimit te leshuara nga laboratore te akredituar nga DA. Financues i projektit eshte Bashkimi Europian

Vlera e projektit	0.8 mln/euro
Afati i fillimit	2007
Afati i përfundimit	2008

Institucioni përfitues direkt në këtë projekt eshte Drejtoria e Pergjithshme e Standardizimit dhe Drejtoria e Akreditimit si institucione ne varesise te METE.

Statusi aktual: Ky projekt eshte ne fazen e shpalljes se fituesit

2-Mbështetje për standartet, certifikimin dhe akreditimin “CARDS 2006”

Objektivi i përgjithshëm është kontributi në lehtësimin e tregëtisë ndërkombëtare për mallrat shqiptare duke garantuar në të njëjtën kohë edhe mbrojtjen e konsumatorit, nëpërmjet:

- Përshtatjes së praktikave shqiptare në fushën e standarteve, testimit të certifikimit e inspektimit dhe akreditimit me rregulloret e BE-së;
- Bërjes funksionale të organizmit të ri të akreditimit;
- Përmirësimit të institucioneve të përfshira në procesin e vlerësimit të konformitetit, duke përfshirë laboratorët;
- Rritjes së vetëdijes mbi standartet dhe certifikimin, duke përfshirë edhe prodhuesit shqiptarë.

Vlera e projektit	0.4 mln Euro
Afati i fillimit	2005
Afati i përfundimit	2007

Projekti bazohet në projektin e standarteve dhe çertifikimit të programit CARDS 2001, i cili përqendrohet më shumë në mbështetjen për Drejtorinë e Përgjithshme të Standartizimit. Projekti lidhet ngushtësisht me projektet e metrologjisë dhe mbikqyrjes së tregut të përfshira në këtë program.

3-Metrologjia ne Shqiperi

Ky projekt financohet ne kuadër te programit “CARDS 2003” . Objektivi i përgjithshëm është kontributi për rritjen e mundësive të eksportit për produktet shqiptare me një cilësi më të mirë të prodhimi, nëpërmjet:

Vlerësimit të nevojave për metrologjinë, duke zhvilluar një strategji dhe duke e zbatuar atë për fushat e zgjedhura si prioritare;

- Ndhimesës në adoptimin e udhëzuesve, modeleve të rregullave ndërkombëtare dhe kërkesave teknike të BE-së;
- Përmirësimit të kapaciteteve administruese të Drejtorisë Kombëtare të Metrologjisë dhe Kalibrimit (DKMK);
- Zhvillimit të një programi trainimi për DKMK-në;
- Rritjes së vetëdijes së publikut mbi metrologjinë.

Vlera e Projektit	1.3 milion Euro
Afati i fillimit	2004
Afati i përfundimit	2007

Projekti është bazuar në aktivitetet e mëparshme të BE-së në këtë fushë dhe ka lidhje të ngushta me projektet e standarteve dhe mbikqyrjes së tregut, përfshirë në këtë program dhe në programet dypalëshe me DKMK-në.

Projekti do të kontraktohet direkt me Qendrën e përbashkët të kërkimeve, Institutin e Materialeve të Referencës dhe Matjeve (IMRM), i cili është një organizëm evropian i krijuar për të nxitur një sistem të përbashkët evropian të matjeve, në mbështetje të politikave të BE-së, veçanërisht të atyre për mbrojtjen e shëndetit dhe konsumatorit, ambientin, bujqësinë, tregun e brendshëm dhe standartet industriale.

4-Mbështetje për forcimin e kapaciteteve të strukturave të ndihmës shtetërore - CARDS 2005

Qëlli i këtij projekti është rritja e kapaciteteve për analizën e skemave të ndihmës dhe ndihmave individuale në përputhje me legjislacionin e ndihmës shtetërore, si dhe rritja e transparencës në zbatimin e parimeve bazë të ndihmës shtetërore në Shqipëri.

Aktivitetet kryesore

- (1) Ekspertizë afatshkurtër për: (i) zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë vlerësimit të skemave të ndihmës shtetërore; shqyrtimi i propozimeve të paketës fiskale për çdo vit,(ii) përgatitja e raporteve vjetore sipas metodologjisë së përdorur nga Komisioni Evropian (iii) përgatitja e hartës rajonale, në bazë të të dhënave ekzistuese të GDP-së.
- (2) Trajnimi i stafit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Konkurrencës, ose pranë strukturave homologe të shteteve anëtare.

Vlera e financimit	200 000 Euro ose 24.6 milion leke
Afati i fillimit	2007
Afati i perfundimit	2008

Ne pergjithesi jane realizuar disa nga aktivitetet e projektit. Gjate vitit 2007 nuk eshte disbursuar vlera prej 4200 Euro (ngritje kapacitetesh) per arsye te vonesave ne shlyerjen e detyrimeve nga pala Shqiptare.

❖ FINANCIME TE REJA TE ANGAZHUARA GJATE VITIT 2007

Gjate vitit 2007 pervec financimeve te huaja te planifikuara do te evidentonim dhe angazhimin e projekte te reja marreveshjet financiare te cilave jane lidhur ne dhjetor te vitit 2007 dhe priten te implementohen gjate viti 2008 e ne vazhdim. Ne kete kontekst si te tilla do te cilesonim grantin Zviceran i cili konsiston ne studimin e fizibilitetit te digave mbi kaskaden e lumit Drin dhe Mat si dhe marreveshjen me Qeverine Italiane me nje vlere prej 5 ml/Euro mbi “ Zhvillimin e qendrueshem dhe reduktimin e emetimit te gazit, me efekt sere”.

1-Studimi i fizibilitetit per Investimet ne sigurimin e digave ne kaskaden e lumit Drin dhe Mat.

Projekti synon ne kryerjen e studimit te fizibilitetit qe do te sherbeje si baze per pergatitjen e nje projekti pasues per te zbatuar investimet e plota ne sigurine e digave ne kaskaden e lumit Drin dhe Mat.

Vlera e projektit eshte 1.5 mln CHF dhe financohet nga qeveria Zvicerane. Mareveshja me qeverine Zvicerane eshte lidhur me date 31.12.2007 dhe Disbursimi pritet te filloje ne fillim te vitit 2008.

2- Zhvillimi i qendrueshem dhe reduktimi i emetimit te gazit me efekt sere.

Projekti synon ne identifikimin e projekteve te perbashketa pilot qe do te zbatohen ne Republikën e Shqiperise , ne baze te dispozitave te nenit 12 te protokollit te Kiotos, per hartimin dhe testimin e bashkepunimit dypalesh si ne gjenerimin e CER-ve dhe per mbeshtetjen e zhvillimit te qendrueshem dhe reduktimin e emisioneve te gazrave sere ne Republikën e Shqiperise. Projektet e perbashketa do te mbulojne fushat e meposhtme:

- Fushen e eficences se energjise
- Fushen e energjise se rinovueshme.

Kjo mbeshtetje financiare dhurohet nga Ministria e Mjedisit, Tokes dhe Detit e Republikës Italiane dhe kap shumen prej 5 mln/Euro. Afati i implementimit te projektit do te jete 3 vjet dhe parashikohet qe dhe realizimi i disbursimeve te behet brenda ketij afati.